

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik		
Titulli i lëndës:	Mikroekonomi e ndërmjetme		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II-të		
Numri i orëve në javë:	2+1		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Florentina Xhelili Krasniqi		
Detajet kontaktuese:	florentina.xhelili@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:			
	Kjo lëndë synon të zgjerojë njohuritë e studentëve mbi konceptet mikroekonomike të cilat përfshijnë teorinë konsumatore, teorinë e kostove dhe të prodhimit, strukturat e tregut si dhe teorinë e lojrave, informatat asimetrike, kontratat dhe rrezikun moral.		
Qëllimet e lëndës:			
	Lënda ka për qëllim që: <ul style="list-style-type: none"> • Të ofrojë njohuri të teorisë mikroekonomike të ndërmjetme; • Të tregojë se si teoria moderne mikroekonomike mund të jetë dhe përdoret për të studiuar një sërë problemesh në ekonomi; • Të tregojë si të ndërtohen dhe analizohen modele të ndryshme të dukurive ekonomike. 		
Rezultatet e pritura të nxënies:			
	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë dhe analizojnë teorinë mikroekonomike lidhur me sjelljen e konsumatorëve dhe të firmave në situata të ndryshme të tregut; • Të zbatojnë modele mikroekonomike për të dizenuar zgjidhje për çështjet ekonomike praktike; • Të vlerësojnë teorinë dhe modelet mikroekonomike në aspektin e implikimeve, avantazheve dhe kufizimeve të tyre. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjërata	2	14	28
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokviume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	2	9	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet ,etj	3	3	9
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Në javë, studentët vijojnë dy orë ligjërata dhe një orë ushtrime. Gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve studentët prezantojnë punën e tyre dhe angazhohen në diskutime. Mësimdhënia realizohet përmes ligjëratave dhe diskutimeve interaktive, punës individuale apo grupe rreth çështjeve specifike, kuizeve dhe prezantimeve të punimeve seminarike.</p> <p>Konsultimet me studentë ofrohen në orarin e përcaktuar.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Testi i ndërmjetëm: 35% • Pjesmarrja aktive në klasë: 10% • Punimi seminarik dhe prezantimi: 10% • Kuize: 5% • Provimi final: 40% 		
Literatura			
Literatura bazë:	<p>Hal R. Varian & Marc Melitz, <i>Intermediate Microeconomics: A Modern Approach</i>, W. W. Norton & Company, 2024 (Tenth edition).</p> <p>Jefferey M. Perloff, <i>Microeconomics</i>, Global Edition, Pearson Education Limited, 2023.</p> <p>Patrick M. Emerson (2019), <i>Intermediate Microeconomics</i>, Oregon State University.</p>		
Literatura shtesë:	<p>J. Hirshleifer, A. Glazer, and D. Hirshleifer, <i>Price Theory and Applications</i>, Cambridge University Press, 7th Edition.</p>		

	<p>Florentina Xhelili, <i>Strukturat e tregut</i>, 2018, IFK, Prishtinë.</p> <p>Hal R. Varian, <i>Mikroekonomia, trajtim modern</i>, Onrufi, Tiranë (Botim i përkthyer në gjuhën shqipe).</p> <p>Këto materiale do të pasurohen edhe me punime shkencore si dhe me burime tjera në internet mbi çështjet aktuale ekonomike.</p> <p>Materialet shtesë do të ngarkohen në SEMS në seksionin "Literatura".</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet/n
Parë	Hyrje në lëndë dhe prezantimi i syllabusit
Dytë	Kufizimi buxhetor
Tretë	Preferencat
Katërt	Dobia
Pestë	Zgjedhja optimale
Gjashtë	Kërkesa
Shtatë	Testi i ndërmjetëm
Tetë	Teknologjia
Nëntë	Maksimizimi i fitimit
Dhjetë	Minimizimi i kostos dhe lakoret e kostove
Njëmbëdhjetë	Strukturat e tregut
Dymbëdhjetë	Teoria e lojës dhe sjellja strategjike e firmave
Trembëdhjetë	Informatat Asimetrike: Perloff, Kapitulli 19
Katërmëdhjetë	Kontratat dhe Rreziku Moral: Perloff, Kapitulli 20
Pesëmbëdhjetë	Prezantimi i punimeve seminarike

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet të respektojnë kodin e sjelljes gjatë ligjëratave dhe provimeve dhe në komunikim me stafin akademik.